



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 18/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi, kryesues, Muhamet Rexha dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkritazi me apelin e Subjektit Politik Partia Liberale Malazeze (CLS), paraqitur kundër vendimit të datës 18.02.2014 me nr. 349/2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mosdorëzimit të Raportit Financiar të Fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 27.02.2014, mori këtë:

## V E N D I M

**Refuzohet si i pabazuar apeli** i Subjektit Politik Partia Liberale Malazeze (CLS), paraqitur kundër vendimit të datës 18.02.2014 me nr. 349/2014 të KQZ-së

### Arsyetim

PZAP-i, me datën 25.02.2014, ka pranuar ankesë, nga Subjektit Politik Partia Liberale Malazeze (CLS), paraqitur kundër vendimit të datës 18.02.2014 me nr. të protokollit 349/2014 të KQZ-së-ZRPPC-së, në të cilën thekson se KQZ-ZRPPC me datë 18.02.2014 ka marr vendim, me të cilën ka gjobitur subjektin politik Partia Liberale Malazeze për shkak se nuk ka dorëzuar Raportin e Deklarimit Financiar lidhur me shpenzimet për Zgjedhjet Lokale 2013.

Parashtruesi i apelit nuk ka bashkangjitur asnjë provë apo dëshmi lidhur me pretendimet ankimore.

PZAP-i, në kuptim të nenit 10 paragrafi 1 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi KQZ-në më datën 25.02.2014, për apelin dhe ka kërkuar që të përgjigjet. KQZ-ja në përgjigje ndaj apelit të lartpërmendur ka theksuar se më datë 18 shkurt 2014 KQZ ka marr vendim për shqiptimin e gjobës duke u bazuar në nenin 21 të Ligjit nr. 04/L-212 Për Financimin e Subjekteve Politike, duke shtuar se përfaqësuesit financiar të subjekteve politike kanë qenë të ftuara nga Zyra për Regjistrim që të marrin pjesë në trajnim, i cili është mbajtur për mënyrën e plotësimit të raportit të shpenzimeve të fushatës zgjedhore.

PZAP-i, pas administrimit të pretendimeve ankimore, vendimit kontestues të datës 18.02.2014 me numër të protokollit 349-2014 të KQZ-së, nxori se:

**Apeli është i pabazuar.**

PZAP-i, ankesën e parashtruar nga pala ankuese e ka rikualifikuar si apel duke u bazuar në nenin 1 paragrafi 8 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, pasi që ka konsideruar se ankesa e dorëzuar do të trajtohet në mënyrën më të duhur si apelim.

Me vendimin e kontestuar me numër 349/2014 të datës 18.02.2014, i është shqiptuar gjoba në lartësi prej 1000 euro subjektit politik CLS, për shkak të vonesës së deklarimit të raportit financiar për periudhën e fushatës zgjedhore të zgjedhjeve lokale të vitit 2013 siç kërkohet në bazë të Nenit 40.1 (Kërkesat për Deklarim Financiar) të LZP-së, në të cilën dispozitë përcaktohet se: *çdo subjekt politik i certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhje, dorëzon Raportet e Deklarimit Financiar të Fushatës së Subjektit, duke i përfshirë të gjitha degët dhe pjesët përbërëse të tij, për periudhën që fillon nëntëdhjetë (90) ditë para zgjedhjeve dhe me mbarim në ditën e zgjedhjeve. Raporti i Publikimit Financiar për Fushatën dorëzohet jo më vonë se dyzetë e pesë (45) ditë kalendarike pas ditës së zgjedhjeve.*

Bazuar në arsyet e theksuar më lartë se subjekti politik ka rënë në kundërshtim me dispozitën e lart theksuar ligjore për shkak të mos deklarimit financiar gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, PZAP-i konstatoi se KQZ-ja, ka vepruar drejt me rastin e vendosjes së gjobës si në pikën e parë të dispozitivit të vendimit të ankimuar, ndaj subjektit politik CLS, ngase gjoba e shqiptuar është konform dispozitave ligjore të Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike.

Andaj, bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, në të cilin theksohet se: *PZAP-i refuzon apelet të cilat nuk i përmbushin standardet*, prandaj bazuar në dispozitat e nenit të cekur më lart u vendosi si në dispozitivë të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

Anr. 18/2014 më datën 27.02.2014.

**Kryesuesi i Panelit  
Xhevdet Abazi**



***Këshillë Juridike:*** *Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*